



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E LISTAVE EMËRORE TË SHTETASVE TË CILËT MUND TË EMËROHEN KRYESISHT ANËTARË TË KQV-VE PËR ZGJEDHJET PËR NË ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 10.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare

shqyrtoi çështjen me

OBJEKT: Për miratim të listave emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1, gërma "a", nenin 37, nenin 38, i ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

KQZ pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe propozimet e depozituara,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në zbatim të përcaktimeve të Udhëzimit nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", i ndryshuar, ka publikuar në gazeta dhe faqen e internetit njoftimin për shprehje interesi nga shtetas që janë të gatshëm të ushtrojnë detyrën e anëtarit të KQV-së për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30 qershor 2019.

KQZ, përmes njoftimit publik informoi shtetasit për kushtet për t'u emëruar anëtar i KQV-ve, në respektim të përcaktimeve të nenit 38 të Kodit Zgjedhor, dokumentacionin që duhej paraqitur dhe afatin e aplikimit.

Për shtetasit që kanë shprehur interes për tu emëruar kryesisht anëtarë të KQV në përgjigje të njoftimit publik të KQZ-së, përmes kërkesës të shoqëruar me dokumentacion, në sejcilën prej 61 zonave zgjedhore, kryhet verifikimi i të dhënave për përmbushjen e kushteve të përcaktuara në



Nr. 828 i Vendimit

Data 10.06.2019 e Vendimit Ora 14 :00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

nenin 37 dhe 38 të Kodit Zgjedhor. Për kushtin e përcaktur në nenin 38, pika 1, gërma "ç", verifikimi i kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

DPB me shkresën nr. 8508/1 prot., datë 7.06.2019, ka kthyer përgjigje për rezultatet e verifikimit të gjendjes gjyqësore të shtetasve me vendbanim në bashkitë si më poshtë:

1. Bashkia Fushë-Arrëz	19 shtetas
2. Bashkia Durrës	158 shtetas
3. Bashkia Kavajë	84 shtetas
4. Bashkia Rrogozhinë	58 shtetas
5. Bashkia Peqin	78 shtetas
6. Bashkia Gramsh	70 shtetas
7. Bashkia Lushnjë	170 shtetas

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur dhe verifikimit të të dhënave, rezulton se shtetasit që kanë shprehur interes për tu emëruar kryesisht anëtarë të KQV në shtatë zonat zgjedhore si më sipër listuar, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 37 dhe 38 të Kodit Zgjedhor, me përjashtim të një shtetasi, banor i Zonës Zgjedhore, Bashkia Kavajë.

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve bazuar në nenin 23, pika 1, nenin 37, nenin 38, i ligjit Nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.8, Bashkia Fushë Arrëz, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur.
2. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.21, nr. 22, nr. 23, nr 24, Bashkia Durrës, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 2 bashkëlidhur.
3. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.42, Bashkia Kavajë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 3 bashkëlidhur.
4. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.43, Bashkia Rrogozhinë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 4 bashkëlidhur.
5. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.44, Bashkia Peqin, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 5 bashkëlidhur.



Nr. 828 i Vendimit

Data 10.06.2019 e Vendimit Ora 14 :00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019

6. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-së nr.51, Bashkia Gramsh, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 6 bashkëlidhur.
7. Të miratojë listën emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve të ZAZ-ve nr.54, nr.55 Bashkia Lushnjë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019, sipas lidhjes 7 bashkëlidhur.
8. Shtetasit, sipas lidhjeve bashkëlidhur, duhet të marrin pjesë në trajnimin e detyrueshëm që do të organizojë KQZ-ja për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019.
9. KZAZ nr. 8, 21, 22, 23, 24, 42, 43, 44, 51, 54, 55, të emërojnë kryesisht anëtarë të KQV-ve deri në plotësimin e numrit të nevojshëm të anëtarëve për vendimmarrje, duke përzgjedhur shtetas nga lista e miratuar sipas procedurave të Udhëzimit të KQZ nr. 4, datë 19.02.2013 "Për procedurat e përzgjedhjes dhe trajnimit të shtetasve që mund të emërohen kryesisht nga KQZ, për plotësimin e vakancës së krijuar në KZAZ dhe KQV", i ndryshuar.
10. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
11. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda pesë ditëve nga shpallja e tij.

Denar	BIBA -	Zv/Kryetar
Bledar	SKËNDERI-	Anëtar
Edlira	JORGAQI-	Anëtare
Rezarta	BITRI-	Anëtare



Nr. 828 i Vendimit

Data 10.06.2019 e Vendimit Ora 14 :00 e Vendimit

Për miratimin e listës emërore të shtetasve të cilët mund të emërohen kryesisht anëtarë të KQV-ve, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të datës 30 qershor 2019